



# MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE PËR SHËRBIMET SOCIALE PUBLIKE

**Mbrojtja e të dhënave personale është  
një e drejtë që njihet me kushtetutë dhe ligj.**

Të dhënat personale janë të gjitha ato që e bëjnë një person të identifikueshëm (emri dhe mbiemri, karta e identitetit, adresa, telefoni, fotot, videot etj). Gjithashtu janë të dhëna personale, informacionet, të dhënat shëndetësore, ekonomike etj, të një personi konkret.

Këto të dhëna janë të mbrojtura nga ligji “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe mund të përpunohen vetëm nëse janë të nevojshme për qëllimet për të cilat kërkohen.

Shërbimeve sociale për të kryer punën e tyre i nevojiten të dhënat e tua personale sepse pa ato nuk është e mundur që ato të ofrojnë ndihmën që ty të nevojitet, p.sh -nuk mund të marrësh një subvencion nëse ti nuk jep të dhënat e duhura për përpunimin e tyre.

Kur ju jepni të dhënat tuaja personale për një ndihmë ose subvencion, për të krijuar historinë tuaj sociale, për të aplikuar për pranimin në një qendër ose rezidence, për të kërkuar një ndihmë sociale, për të bërë birësimin e një fëmije ose çfarë do lloj situatë



tjetër, përpunuesi i të dhënave duhet t'ju informojë që:


- ♣ Për çfarë i mbledh të dhënat tuaja;
- ♣ Kush është përdoruesi përgjegjës i këtyre të dhënave dhe si mund të lidheni me to;
- ♣ Nëse është apo jo e detyrueshme mbledhja e të gjitha të dhënave dhe çfarë mund të ndodhë nëse refuzohet e drejta e aksesit në to.
- ♣ Ju keni të drejtë për të kërkuar modifikimin e gabimeve ose të parregullsive, fshirjen e të dhënave që nuk janë të nevojshme, etj.

Ky informacion duhet të jetë i përfshirë në formatet e mbledhjes së të dhënave, në flet-palosje, internet, etj, ose në mënyrë verbale. Nëse këtë gjë ta kërkojnë në telefon, duhet t'ju japin të njëjtin informacion.

Nëse gjendesh ose shkon në vende institucionale të shërbimeve sociale, ku janë të instaluara video-survejuese, bashkëngjitur me këtë, duhet të jetë dhe njoftimi mbi këtë instalim si dhe përgjegjësi i këtij survejimi, për më tepër përgjegjësi duhet të ketë në dispozicion çfarëdo lloj mase informuese p.sh: fletë-palosje, etj.

### **Ju keni të drejtë që:**

- ♣ Të dhënat tuaja mos të përdoren për qëllime të ndryshme.
- ♣ Mos të kërkoen më tepër të dhëna personale nga çfarë është e nevojshme, p.sh të dihet orientimi juaj seksual.
- ♣ Të dhënat tuaja nuk duhet t'i shpërndahen dikujt tjetër për të cilin ti nuk ke dhënë pëlqim.
- ♣ Informacioni juaj personal duhet të përpunohet me një siguri maksimale.
- ♣ Nuk duhet të përgjigjesh kur një shërbim social të pyet mbi ideologjinë, krijimet ose fenë tënde sepse për të qenë përfitues i një shërbimi social, çfarëdo që ajo të jetë, nuk është e nevojshme të dihen ideologjitë ose bindjet e tua politike.
- ♣ Vetëm përfaqësuesit që merren me shërbimet sociale mund të kenë akses në përdorimin e informacionit tuaj, gjithmonë në qoftë se ti e lejon këtë gjë me bindje të plotë.
- ♣ Të dhënat tuaja personale duhet të jenë të përditësuara dhe të modifikohen kur ato ndryshojnë.



Për të ushtruar të drejtat tuaja me shkrim duhet të shkoni tek kontrolluesi i të dhënave/marrësi i të dhënave tuaja personale. Në rast se ju nuk merrni një përgjigje, atëherë mund t'i drejtoheni Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale si autoriteti i pavarur që mbron privatësinë tuaj duke ushtruar kompetencat ligjore që i njeh ligji.